

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVE,–Departamenti për Krime te Rënda, në Trupin Gjykuese të përbërë nga Gjyqtari Shaqir Zika, Kryetari i Trupit Gjykues, dhe Gjyqtarëve Drilon Haraçia dhe Malësor Kryeziu, anëtar të Trupit Gjykuese, me pjesëmarrjen procesmbajtëses Bute Ramosaj, në lëndën penale kundër të akuzuarve H. S. B. , nga Gj. , për shkak te veprës penale te mashtrimit nga neni 261 prg 2 lidhur me prg 1 te KPRK-se, i akuzuar me aktakuzat e i Prokurorisë Themelore ne Gjakove, - Departamenti i Krimeve te Rënda, PP/I. 111-A/2013, te dt. 14.01.2014, pas mbajtjes te seancave të shqyrtimit kryesore me dt. 11.01.2018, dhe me dt. 16.04.2018, me pjesëmarrjen e Prokurorit te Shtetit te PTH ne Gjakovë Agron Matjani, të akuzuarit H.B. se bashku me mbrojtësin e tij av.T. B. nga Gj. , dhe te dëmtuarës V. G. , me dt. .. murrë dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

1. i akuzuari: H. B. , i lindur me . në fshatin Deve K- Gj. , tani me banim ne Gjakove, rruga “A.Ç. ” nr. 18/2, nga i ati S. dhe ëma H. e lindura P. i martuar, i ati i tre fëmije, ka te kryer shkollën e mesme, i pa pune, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i R. së Kosovës.

Komform nenit 363 prg 1 pika 1.3 te KPPK-së,

REFUZOHET AKUZA

Për shkak së:

I. Se me dt. ..., ne cilësinë e mjekut kardiolog ka vepruar pranë Spitalit “H. ” ne Gj. me qellim qe vetit te ja sjelli dobi pasurore te kundër ligjshëm mashtron te dëmtuarën V. G. te njëjtën e vene ne lajthim ne paraqitje te rreme te fakteve, dhe shtynë te dëmtuarën qe te veproi ne dem te pasurisë së saj, ashtu qe edhe pse nuk ka pasur te kryer Fakultetin e Mjekësisë ne Francë, i akuzuari është paraqitur si mjekë - kardiolog i Zemrës, duke ja caktuar diagnozën te dëmtuarës se ka një vrimë ne zemër, ku duhet te bëhet intervenimi kirurgjik dhe përket ka marrë shumen prej 6.000€, dhe nuk ka bërë intervenim kirurgjik në spitalin “ heart” ashtu qe e dëmtuara ka qene e obliguar te shkoi ne Gj. ku dhe është bërë intervenimi kirurgjik me zemër te hapur për te cilën ka paguar shumen prej 30.000€. dhe me kete veprim ka dëmtuar te dëmtuarën V. G.

- këso dore kishte për te kryer vepër penale mashtrimit nga neni 261 prg 2 lidhur me prg 1 te KPRK-se,

E dëmtuara V. V. G. nga fshati H. K- P. udhëzohet ne kontest te rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Shpenzimet e procedurës penale bije ne llogari te mjeteve buxhetore te kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Gjakove,- Departamenti për Krime te Rënda, ka ngritur aktakuzë PP/I. nr. 111-A/2013, te dt. 14.01.2014, kundër te akuzuarit H.B. për shkak te veprave penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare, nga neni 422 prg 1 te KPRK-se.

Me aktgjykimin e kësaj Gjykate PKR.nr. 10/2014, te dt. 05.09.2016, i akuzuari H. B. është shpallur fajtores për vepër penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtare nga neni 422 prg 1 te KPRK-se, dhe te njëjti i është shqiptuar dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej 1 (një) vite e 6 (gjashte) muaj, dhe i njëjti aktgjykim ne këtë pjese te dispozitivit te akuzës me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PAKR.nr. te dt., në pikën III te dispozitivit te aktgjykimit ku është shqiptuar dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashte) muaj, është marrë si i vërtetuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit H. B. av. T. B. ka parashtruar kërkesë për mbrojtje te ligjshmërisë dhe me aktgjykimin e Gjykatës Supreme te Kosovës PML.nr. .. te dt. ... është aprovuar kërkesa për mbrojtje te ligjshmërisë së te dënuarit H. B. dhe është anuluar aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Gjakove, PKR.nr. ... te dt. ... dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit te Kosovës PAKR.nr. ..., te dt. ... ne pjesën qe ka te beje me vepër penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtare nga neni 422 prg 1 te KPRK-se, ne këtë pjesë lënda është kthyer Gjykatës së shkalles se parë ne rivendosje.

Pas mbajtjeve te seancave te shqyrtimeve gjyqësore përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Agron Matjani ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara gjate seancave te shqyrtimeve gjyqësore marrjes ne pyetje ne cilësinë e dëshmitares te dëmtuarën V. G. procedimit te dëshmitarit H. B. dëshmitarit dr. O. H, dhe dr. G. B., është vërtetuar fakti se i akuzuari H. B. i ka mashtruar këtu te dëmtuarën V. G. duke marrë shumen e te hollave ne shume prej 6.000€, andaj ne këtë drejtim ka bërë përmirësimin e dispozitivit te akuzës dhe kualifikimit juridik nga vepra penale e keqpërdorimit te detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtare nga neni 422 prg 1 ne vepër penale te mashtrimit nga neni 261 prg 2 lidhur me prg 1 te KPRK-se, dhe se kjo gjendje faktike është vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarës V. G. e cila ka theksuar se është kontrolluar te mjeku H. B. dhe pas ca kontrolleve ka thene se duhet te behet intervenimi kirurgjike ne zemër te hapur, dhe përket duhet te paguaj shumen prej 6.000€, ashtu qe baba i saj V. B. ka paguar shumen prej 6.000€ , ne

konto te spitalit "H." te pronarit H. B. dhe i akuzuari për te arsyetuar këtë shume te marrë te te hollave i njëjti kinse ka bërë intervenim me amplacer ne zemrën e saj dhe se kjo ka rezultuar si e pa suksesshme dhe ajo është detyruar qe te shkoi ne Gjermani, ku dhe është bërë operacion ne zemër te hapur dhe përket ka pasur shpenzime ne shume prej 30.000€.

Po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit H. B. i cili ka theksuar se dëmtuarën V. G. e ka vajze te axhës dhe ajo ka qene e smut prej zemre dhe e njëjta është shëruar ne spitalin "H." te Gjakove, ku mjeku H. B. e ka mjekuar dhe nga baba i saj ka kërkuar qe te paguaj shumen prej 6.000€, te cilën pagese e ka bërë, e pasi qe nuk e ka kryer punën nuk e ka operuar, dhe nga i njëjti ka kërkuar qe ti ktheje shumën prej 6.000€. I njëjti ka premtuar qe do ti ktheje këto te holla, e me vonë i njëjti fare nuk është lajmëruar as ne telefon, dhe i ka ikur kontakteve me ta ne spital dhe gjate vizitës te dr. O. H. i cili pas shiqimit te dokumentacionit mjekësore i ka treguar se ky lloj i operacionit nuk behet ne spitalin "H." e as ne Kosove por duhet te intervenohet Jashtë shtetit ne T. i apo ne Gjermani. I akuzuari H. edhe pse nuk e ka kryer operacionit ne spitalin "H." i njëjti asnjëherë nuk ja ka kthyer te hollat ne shumë prej 6.000€.

Andaj duke patur parasysh këto fakte dhe prova Gjykata mbrojtjen e te akuzuarit H. B. duhet ta hudhi poshtë si te pa bazuar se lidhur me këtë shume prej 6.000€, ne spitalin e tij "H." ne Gj. Mjeket kanë intervenuar me amplacer, dhe se i njëjti te dëmtuarës i ka premtuar intervenim ne zemër te hapur, i njëjti ne mbrojtje te tij me qellim te shmangies juridiko- penale, andaj mbrojtjen e tij është ne kundërshtim me provat e administruara dhe se i njëjti ka kryer vepër penale te mashtrimit ne dëm te dëmtuarës V. G.

Deri te rikualifikimi i veprës e kam bere dhe ne baze te vërejtjeve qe janë dhënë nga Gjykata Supreme e Kosovës, që i ka anuluar te dy aktgjykimet te shkalles se pare dhe te dytë, duke kthyer qeshtjen ne rigjykim duke apostrofuar ne faktin se i akuzuari ka qene i akuzuar për keqpërdorim t e pozitës apo autoritetit zyrtare nga neni 422 prg 1 te KPRK-se, qe Gjykata duhet te analizoi faktin se i njëjti e ka pasur ne cilësinë e personit zyrtare ne kohen e kryerjes se veprës penale me dt. 29.07.2008.

Andaj i ka propozuar Trupit Gjykuese qe te akuzuarin H. B. te shpalli fajtores për vepër penale te mashtrimit nga neni 261 prg 2 lidhur me prg 1 te KPRK-se, dhe te njëjti ti shqiptohet një dënim sipas Ligjit duke marrë parasysh te gjitha rrethanat renduese dhe lehtësuese dhe se i akuzuari një kohe te gjate e ka mbajtur ne lajthim te dëmtuarën V.G.

E dëmtuara V. G. ne fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se ne tërësi e përkrah fjalën përfundimtare te Prokurorit te shtetit, ndaj te akuzuarit i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe i ka parashtruar kërkesën pasurore juridike ne shume prej 6.000€.

Mbrojtësi i të akuzuarit H. B. , av. T. B. ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se po te ekzaminohet prova me ekspertize mjeko- ligjore, për të cilën është

pajtuar dhe e dëmtuara dot e qartësohej se ne veprime mjekësore që është ndërmarrë nga specialistet e mjekësisë invazive është kryer intervenimi me amplacer mirëpo i njëjti veprim ka dalur i pa suksesshëm për çka me përpara e dëmtuara është informuar dhe si shërbim se bashku me pajisjet e përdorura tejkalojnë shumen prej 6.000€, te cilën shume e ka paguar e dëmtuara. Me gjithë atë nuk është argumentuar se këtu i akuzuari e ka mashtruar te dëmtuarën nga se ky nuk ka pasur mundësi qe te njëjtës ti paguaj operimin ne zëmër te hapur nga se ky operacion e ka koston e lartë. Gatishmëria e tij për ti ndihmuar ne spital ku ka punuar e qe ne te ardhmen është pritur qe eventualisht ky spital te beje operacione ne zëmër te hapur kjo nuk paraqet veprime mashtrimit nga se ajo është vetëm kategori etike. Dhe se i akuzuari praktikisht përmes mjekeve specialist te cilat i ka paguar dhe pajisjeve te instaluar për nevojat e shërimit te dëmtuarës objektivisht ka harxhuar shumen prej 6.000€.

Edhe po te qëndroi fakti i vërtetimeve te fakteve si ne aktakuze tani te ndryshuar te ri kualifikuar këtu te ketë mashtruar te dëmtuarën i cili fakt assesi nuk qëndron ndoshta ne veprimet e tija mund te ketë elemente te veprës penale te mashtrimit nga neni 261 prg 1 edhe po te vërtetohet kjo ne rastin konkrete ka ardhur gjere te parashtrimi absolut i ndjekjes penale.

Pas analizimit te provave te propozuar ne aktakuze e te proceduara gjate shqyrtimit gjyqësore si dhe provave te propozuara nga mbrojtësit vlerësimit te tyre një nga një dhe ne lidhshmëri njëra tjetrën. Trupi Gjykuese ka ardhur ne përfundim dhe ka marrë aktgjykim refuzues, nga se ne rastin konkrete ka ardhur gjere te parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Dhe se vepra penale është kryer me dt. dhe nga kjo kohe ka kaluar afati mbi 6 vite, nga se për vepër penale te mashtrimit nga neni 261 prg 1 është parapare dënimi me gjobe apo burgim deri në 3 vite.

Për te ekzistuar vepra penale e mashtrimit nga neni 261 prg 2 pra te jete vepër e kualifikuar nëse vepra penale nga prg 1 i këtij neni rezulton ne dem i cili tejkalon shumen prej 15.000€, kryesi dënohet me burgim prej 6 (gjashte) muajve deri ne 5 (pese) vite. E pasi qe ne rastin konkrete demi qe i është shkaktuar te dëmtuarës është ne shume prej 6.000€, andaj ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet qenesore te veprës penale te mashtrimit nga neni 261 prg 1 ku dënimi është i parapare me gjobe apo me burgim deri ne 3 (tre) vite, andaj ne rastin konkrete ka ardhur gjere te parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Sa i përket pretendimeve te Prokurorit se ne rastin konkrete te dëmtuarës V. G. i është shkaktuar demi ne shume prej 30.000€, kjo gjate shqyrtimit gjyqësorë nuk është vërtetuar dhe se e dëmtuara te i akuzuari ka paguar shumen prej 6.000€, ndërsa shpenzimet qe i ka pasur për intervenim ne zëmër te hapur ne shume prej 22.000€, kjo shumë nuk mund ti vihet ne veprimet inkriminuese për te akuzuarin H. B.

Andaj komform dispozitave te nënti 364 prg 1 pika 1.3 lidhur me nenin 106 prg 1 pika 1.6 e lidhur me nenin 107 prg 8 te KPRK-se. është vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarës që kërkesën pasurore juridike ta realizoi ne kontest te rregullt civil bazohet ne dispozitat e nënti 463 prg 1 lidhur me prg 3 te KPPK-se.

**GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË,-Departamenti Për Krime të Rënda
PKR.nr.100/17, dt. 18.04.2018.**

**Procesmbajtësja
Bute Ramosaj**

**Kryetari i trupit gjykues
Shaqir Zika**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund te parashtrohet ankesë , nëpër mjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit ne Prishtine ne afati prej 15 ditëve nga dita e pranimit te aktgjykimit.